

VENDIM
Nr. 20, datë 13.1.2022

PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË MENAXHIMIT TË SHPENZIMEVE
PUBLIKE PËR VITIN 2022

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 22, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kalendarit të menaxhimit të shpenzimeve publike për vitin 2022, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, njësia përgjegjëse për planifikimin strategjik dhe zhvillimin, në Kryeministri, si dhe të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2022.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

Lidhja nr. 1

KALENDAR I PËR MENAXHIMIN E SHPENZIMEVE PUBLIKE PËR VITIN 2022

PERIUDHA	DATA	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	VEPRIMI PËRKATËS
Janar	5	MoFE	Përgatit dhe paraqet në KM kalendarin e MSHP-së.
Janar	12	KM	Shqyrton dhe miraton kalendarin e MSHP-së.
Janar	13	MoFE	Paraqet në KM Kuadrin Makroekonomik e Fiskal 2023–2025.
Janar	20	KM	Miraton Kuadrin Makroekonomik e Fiskal 2023–2025.
Janar	28	KM	Përgatit dhe miraton projektdokumentin e prioritetëve të politikave 2023–2025 me ndikim në tavanet buxhetore.
Shkurt	15	MoFE	Paraqet në KM tavanet përgatitore të përgatitjes së PBA-së 2023–2025, për fazën strategjike.
Shkurt	23	KM	Shqyrton dhe miraton tavanet përgatitore të përgatitjes së PBA-së 2023–2025, për fazën strategjike.
Shkurt	28	MoFE	Dërgon udhëzimin e përgatitjes së buxhetit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.
Mars	8	KM	Paraqet për informacion në Kuvend Kuadrin Makroekonomik e Fiskal 2023–2025.
Mars–Prill	1 mars–22 prill	Njësitë e qeverisjes së përgjithshme	Përgatisin kërkesat e tyre buxhetore.
Prill	25 prill–26 prill	Njësitë e qeverisjes së përgjithshme	Zhvillojnë takime konsultative me shoqërinë civile për PBA-në 2023–2025.
Maj	2	Njësitë e qeverisjes së përgjithshme	Paraqesin në MoFE kërkesat e tyre buxhetore.
Maj	3–20 maj	MoFE	Kryejnë analizat e kërkesave buxhetore.
Maj	3–20 maj	KM	Analizojnë kërkesat buxhetore bazuar në dokumentin e prioritetëve të politikave 2023–2025.
Maj	23–27 maj	MoFE	Organizon seancat dëgjimore me njësitë e qeverisjes së përgjithshme.
Maj	30–31 maj	MoFE	Prezanton dokumentin e PBA-së 2023–2025, me shoqërinë civile.
Qershor	1	MoFE	Paraqet në KM Kuadrin Makroekonomik e Fiskal të rishikuar (<i>në rast se shihet e nevojshme</i>).
Qershor	8	KM	Miraton Kuadrin Makroekonomik e Fiskal të rishikuar (<i>në rast se shihet e nevojshme</i>).
Qershor	8	KM	Përgatit dhe miraton dokumentin e rishikuar të prioritetëve të politikave 2023–2025, me ndikim në tavanet buxhetore.
Qershor	10	MoFE	Përgatit dokumentin e PBA-së 2023–2025 dhe tavanet përfundimtare të shpenzimeve për PBA-në 2023–2025.
Qershor	22	MoFE	Paraqet dokumentin e PBA-së 2023–2025 dhe tavanet përfundimtare të shpenzimeve për PBA-në 2023–2025, për shqyrtim dhe miratim në KM.
Qershor	29	KM	Miraton dokumentin e PBA-së 2023–2025 dhe tavanet përfundimtare të shpenzimeve të PBA-së 2023–2025.
Korrik	7	MoFE	I paraqet Kuvendit për informacion dokumentin e PBA-së 2023–2025.
Korrik	8	MoFE	Dërgon udhëzimin plotësues të përgatitjes së buxhetit në fazën teknike, në të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme.
Korrik–gusht	11 korrik–31 gusht	Njësitë e qeverisjes së përgjithshme	Përgatisin kërkesat buxhetore të rishikuara, në përputhje me tavanet përfundimtare.

Shtator	1	Njësitë e qeverisjes së përgjithshme	Paraqesin në MFE kërkesat e rishikuara buxhetore.
Shtator	2–14	MoFE	Kryejnë analizat e kërkesave të rishikuara buxhetore.
Shtator	2–14	KM	Analizojnë kërkesat buxhetore bazuar në dokumentin e rishikuar të prioriteteve të politikave 2023–2025.
Shtator	15–23	MoFE	Organizon seancat dëgjimore me njësitë e qeverisjes së përgjithshme.
Tetor	5–13	MoFE	Përgatit projektbuxhetin e vitit 2023, si dhe dokumentin e rishikuar të PBA-së 2023–2025 dhe i paraqet për shqyrtim në KM.
Tetor	15	KM	Miraton projektbuxhetin e vitit 2023, si dhe dokumentin e rishikuar të PBA-së 2023–2025.
Tetor	18	MF	Dërgon për informacion në Kuvend një kopje të dokumentit të rishikuar të PBA-së 2023–2025, të miratuar nga KM-ja.
Tetor	18	KM	I paraqet Kuvendit projektbuxhetin e vitit 2023.